

KËRKESË
Nr. 4451, datë 1.10.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Kulturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Ndërhyrje të përkohshme dhe rehabilituese në sheshin “Nënë Tereza””.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

Pronarët që kanë emrin në lisën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Kulturës.

Vlera totale e shpronësimit është 30 138 832 (tridhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e tetëqind e tridhjetë e dy) lekësh.

Lista

1. Zona kadastrale 8280 me nr.pasurie: 2/341, në pronësi të Endrit Alikaj.
2. Zona kadastrale 8280 ne nr.pasurie: 2/335, në pronësi të Ornela Mansaku.

MINISTRI I KULTURËS
Mirela Kumbaro

LISTA E PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË DO TË
SHPRONËSOHEN PËR MARRJEN NË PËRDORIM TË PËRKOHSHËM PËR INTERES
PUBLIK, TË CILAT PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTTIT “NDËRHYRJE E
PËRKOHSHME DHE REHABILITUESE NË SHESHIN “NËNË TEREZA””

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sipërfaqe		Çmimi lekë/m²		Vlera/lekë			Shënime
				truall	ndërtim	truall	ndërtim	truall	ndërtesë	banesë	
1	Endrit Alikaj	8280	2/341	820.0	56.6	23, 955,0	22,838,269	19,643,100	1,292,646		Sipas kartelës së pasurisë
2	Ornela Mansaku	8280	2/335	135.0	135.0	23, 955,0	44,216,007	3,233,925	5,969,161		Sipas kartelës së pasurisë
				955	191,6			22,877,025	7,261,807		30,138,832
	TOTALI								Lekë		30,138,832